



## A mund të kualifikohet familja ime për ndihmë financiare edhe nëse na ofrohet sigurim shëndetësor nga punëdhënësi im?

### Mbulimi i sigurimit shëndetësor për familjen po bëhet më i përballeshëm

#### Rregulli i ri i kualifikimit për ndihmë financiare përmes “NY State of Health”

- Duke nisur nga data 1 janar 2023, kualifikimi për ndihmë financiare për anëtarët e familjes do të bazohet mbi përballeshmërinë e mbulimit familjar të ofruar nga punëdhënësi.
- Një plan shëndetësor familjar konsiderohet i “përballeshëm” nëse primi është më i ulët se 9.02 për qind e të ardhurave familjare.
- Nëse mbulimi familjar konsiderohet i papërballeshëm, anëtarët e familjes mund të kualifikohen për ndihmë financiare.
- Kjo nuk ndryshon provën e përballeshmërisë për punëmarrësit. Nëse punëmarrësi mund të përfitojë mbulim të përballeshëm të vetëm (vetëm punëmarrësi) përmes punëdhënësit, ai nuk do të kualifikohet për ndihmë financiare nëpërmjet “NY State of Health”. Megjithatë, anëtarët e familjes mund të jenë ende të kualifikueshëm.

#### Rregulli i kualifikimit për ndihmë financiare përpara vitit 2023

- Deri në vitin 2023, sigurimi shëndetësor konsiderohet i “përballeshëm” bazuar në koston e një mbulimi të vetëm (vetëm punëmarrësi).
- Deri në atë moment, nëse primi për mbulimin e vetëm (vetëm punëmarrësi) është më pak se 9.61 për qind e të ardhurave familjare të punëmarrësit. Punëmarrësit që mund të përfitojnë sigurim shëndetësor të përballeshëm përmes punëdhënësit të tyre nuk kualifikohen për ndihmë financiare me një plan të “NY State of Health”.
- Nëse një punëmarrës nuk kualifikohet për ndihmë financiare nëpërmjet “NY State of Health” bazuar në këtë rregull, anëtarët e familjes së punëmarrësit konsiderohen gjithashtu të pakualifikueshëm për ndihmë financiare nëpërmjet “NY State of Health”. E njëjta gjë vlen edhe kur plani shëndetësor familjar i ofruar nga punëdhënësi kushton më shumë se 9.61 për qind e të ardhurave familjare.

#### Si mund të veproni?

- Përdorni instrumentin llogaritës të ndihmës financiare të “NY State of Health”: <https://info.nystateofhealth.ny.gov/estimate-financial-assistance>
- Ky instrument bën një vlerësim për të parë nëse ju ose anëtarët e familjes suaj kualifikoheni për ndihmë financiare. Kualifikueshmëria reale do të përcaktohet në momentin e aplikimit.

Nëse mendoni se ju ose pjesëtarët e familjes tuaj mund të jeni të kualifikueshëm për ndihmë financiare, kontaktoni “NY State of Health” për t’ju ndihmuar me aplikimin:

**Nëpërmjet internetit:**  
[nystateofhealth.ny.gov](https://nystateofhealth.ny.gov)

**Nëpërmjet telefonit:**  
1-855-355-5777 ose  
TTY: 1-800-662-1220

**Personalisht:**  
Ndhimë falas nga një asistent i certifikuar

“NY State of Health” vepron në përputhje me ligjet e zbatueshme federale për të drejtat civile dhe ligjet shtetërore, si dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, origjinës kombëtare, besimit/fesë, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitive gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose e hakmarrjes.